

Flokët i kam të shpeshta dhe të kuqe. Trupin e kam ndoshta pak të shkurtë, mirëpo dukem normal. Nganjëherë bëj shaka (mahitem).

Një ditë, erdhi Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe më gjeti duke ngrënë hurma. E mua mu kishte enjtur syri. Buzëqeshur më pyeti: *“Si po ha hurme, kur e ke syrin të enjtur?”* Unë i thashë: *“Mos ke dert, o i dashuri i All-llahut. Unë mund të ha me syrin tjetër.”*

Kur Ebu Lulu i ra thikë pas shpine Omerit radijall-llahu anhu në namazin e sabahut, e ky pa se po i afrohet vdekja, mua më caktoi t’i fali besimtarët në namaz, deri sa të zgjidhet halifja tjetër.

Detyrën që ma besoi Omeri radijall-llahu anhu, e kreu me dinjitet.

Nga natyra kam qenë shumë bujar, dhe i ndihmoja të varfërit. Këtë e kishte vërejtur edhe Omeri radijall-llahu anhu, sa që në një rast më tha: *“Ti po shpërndan prej pasurisë më tepër se sa të takon.”*

Unë iu përgjigja: *“Ç’do grosh e jap aty ku duhet. A nuk të kujtohet, o halife i muslimanëve, fjala e Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Më i miri prej jush është ai që ushqen të uriturin.”*

E shoh të rrugës që t’ju rrëfej për jetën time.

Babai im ishte nga ata arabë, që ishin shpërngulur në Irak qysh para ardhjes së Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Marrëdhëniet e mira me Kisranë, mbretin Persian, e ndihmuan babain tim që të emërohet për guvernator të regjionit lbih. Në brigjet e Eufratit jetonte në pallatin mbretëror. Në atë pallat u linda edhe unë. Fëmijërinë e jetova si djalë mbreti, por kjo nuk zgjati shumë, sepse papritmas na sulmuan romakët. Vranë tërë popullatën e kësaj ane, robëruan shumë gra e fëmijë, e një ndër ta isha edhe unë.

Kështu e ka kjo jetë. Njëherë jeton si mbret, me të gjitha të mirat përreth vetes, krahas respektin që gëzon, e pastaj sprovoesh me varfëri, e çka është më keq, bëhesh rob i dikujt.

Pjesën tjetër të fëmijërisë e kalova mes romakëve. Ata ndikuan aq tepër në mua, sa që gati ishin duke më asimiluar. Ashtu që gjuhën arabe e pata harruar pothuajse krejtësisht. Por, vullneti i Zotit deshi që unë përsëri të kthehem në mesin e vëllezërve të mi arab. Një njeri nga Hixhazi, i fisit Kelb, më blenë mua, dhe për të fituar edhe më tepër, më shiti në Mekke. Më saktë, tani isha rob i Abdullah ibën Xhudanit.

Sjellja e mirë me njerëzit dhe mendjemprehtësia ime, i ranë në sy zotëriut tim. Ashtu, Abdullah ibën Xhudani kishte

tepër besim në mua, prandaj tërë pasurinë ma la në dorë.

Vazhdova disa vite të mirrem me tregti. Gjatë asaj kohe, pata rastin të udhëtoj nëpër vende të ndryshme, si: në Sham, Jemen, Abisini. Këto udhëtime i sollën fitime të mëdha Abdullahut.

Më kujtohet, kur një ditë më thirri Abdullah ibën Xhudani në shtëpinë e tij, dhe më uli pranë. Me fjalë të ëmbla më tha: *“Gjatë kohës qëndrimit tënd këtu te unë, ke dëshmuar se je njeri besnik, dhe se të punon koka për tregti. Sjellja jote ndaj njerëzve ka qenë korrekte. Më duhet të pranoj se ti je më i merituari për sukseset tona në punë, prandaj kam vendosur që ne të dy të bëhemi shokë në tregti. Falë të qoftë liria, ti nuk je krijuar për rob, andaj prej këtij momenti je i lirë.”*

Nuk mund ta përshkruaj gëzimin tim të asaj dite; unë fitova lirinë, fitova jetën. E ju nuk i dini ndjenjat e një robi. Shpirti i tij është gjithnjë i nënçmuar. Por, kini kujdes, se ju mund të bëheni rob të epsheve tuaja.

Tani më isha njeri i lirë, dhe shok në tregti me ibën Xhudanin.

Pas vdekjes së tij, unë vazhdova të punoj vetë. Fitova një pasuri të madhe, sa që tani isha ndër tregtarët më të mëdhenj në Mekke.

E shoh të arsyeshme t’ju tregoj se, gjithmonë kam ndihmuar të varfërin dhe çdonjërin që ma shtrinte dorën për ndihmë.

Nuk e harroj një ditë të jetës sime, kur unë fitova një nder të madh. Prandaj, ju lutem më lejoni t’ju flas për përkujtimet e mia, se ndoshta dikujt do t’i shërbejnë ato si shembull.

A e dini se ç’ndodhi atë ditë?

Dëgjova se, Muhammed ibën Abdullahu, në shtëpinë e Erkam ibën Erkamit, përgëzonte njerëzit me fenë e re që kishte filluar të shpallet nga Zoti i Madhëruar. Ai thërriste njerëzit që të mos adhurojnë idhujt dhe epshet e tyre, por ta adhurojnë All-llahun e Madhëruar.

Muhammed ibën Abdullahu ishte i njohur në Mekke si njeri besnik dhe i sinqertë. Për moralin dhe besnikërinë e tij fliste e tërë Mekka. Bashkëshortja e tij, Hatixheja radijall-llahu anha, ishte fisnikja e kurejshëve. Njeriu me këtë famë, doemos do të jetë i sinqertë. Pra, ai është Pejgamber i vërtetë. Vendosa që sa më shpejt të takohem me Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Shkova në shtëpinë e Erkam ibën Erkamit, kur, ç’të shoh: para derës së shtëpisë rrinte shoku im i ngushtë, Ammar ibën Jasiri. Si duket, edhe Ammari kishte ardhur për të njëjtin qëllim.

Hymë që të dy brenda ke Erkami, dhe u ulëm pranë

Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai njëherë na sqaroi fenë Islame, kurse ne, pa një pa dy, deklarua she-hadetin dhe u bëmë musliman.

Në shtëpinë e Erkam ibën Erkamit ndejtëm deri në mbrëmje, e pastaj u shpërndamë një nga një, që mos të na hetojnë idhujtarët e Mekkes, sepse, ata nuk kishin aspak mëshirë ndaj muslimanëve kurejshit, e paramendoni se çdo të ndodhte me një të huaj, siç isha unë. Kam qenë rob i tyre; pastaj, unë nuk kisha asnjë farefis, që të mirrte në mbrojtje. Shoku im, Ammari, ishte nga një familje tepër të varfër, sa që nuk i ndihej zëri (nuk e bënin mall). Prej asaj dite, kur me vullnetin e Zotit të Madhëruar u udhëzova në fenë Islame, nuk jam ndarë dot nga Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Isha nxënës në shkollën e tij. Më ka dashur shumë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe më thirrte me emrin Ebu Jahja.

Por, krahas kësaj kënaqësie shpirtërore që ndieja në prezencën e Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, diçka më mundonte shumë. Gjithnjë pyetsha: *“Pse ta fshehim fenë tonë nga paria mekase, kur ne jemi të udhëzuar në fenë e drejtë, e ata janë në dekadencë? Si bëhet që ata të krenohen me besimin e tyre të kotë, e ne gjithnjë të kryejmë ritualet tona fshehurazi?”*

Muslimanët tjerë kishin vërejtur se ç’ishte ajo që më mundonte. Ata e dinin se, dëshira ime e flaktë, për ta deklaruar fenë time para kryeneçëve kurejshit, ishte mbi të gjitha, prandaj më këshillonin të kam durim derisa të përgatiten kushtet për një gjë të tillë.

Megjithatë, unë nuk munda të duroj më tepër. Një mëngjez, dola para mekasve dhe brohorita: *“O mekas, unë jam musliman. All-llahu është Zoti im, kurse Pejgamberi im është Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.”* Nëpër librat e historisë Islame do të lexoni se, shtatë njerëz deklaruan Islamin haptazi para mekasve. Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Ebu Bekri, Bilali, Unë, Habbabi, Ammari dhe nëna e tij.

I kthehemi prapë ngjarjes. Kurejshët më binin me hekur e shkopa gome, por unë nuk ndija asçfarë dhembje. Vazhdova tu flas për fenë, derisa u alivanosa. Dikur erdha në vete, dhe prap vazhdova tu flas, e ata prap më rrahnin dhe ma fyenin fenë dhe Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Aty pranë ka qenë Halid ibën Velidi (para se të bëhet musliman), i cili ishte habitur me trimërinë time dhe guximin tim.

A e dini pse ishte kështu?

Shpirti i cili sinqerisht i ka besuar All-llahut të Madhëruar dhe Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, çdo dhembje që i shkaktohet në rrugë për ta ndihmuar fenë, i

duket e ëmbël.

Maltretimet ndaj as'habëve nuk kishin të ndalur, prandaj Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem na urdhëroi që të shpërngulemi për në Etiopi. Mua ky urdhër nuk më shkoi për shtati, sepse ishte e pamundshme të largohem nga Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Dëshira ime që të rri me Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem u plotësua, ashtu që mbeta në Mekke.

Vite të rënda ishin ato në Mekke, derisa na urdhëroi Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem që të shpërngulemi për në Medine. Kërkova leje që të rri me të, e të shpërngulemi së bashku. Por All-llahu i Madhëruar kishte caktuar ndryshe.

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem u shpërngul së bashku me Ebu Bekrin, ndërsa unë mbeta në Mekke. Por Mekka pa Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem më dukej e zbrazët dhe e shkretë, andaj vendosa që edhe unë tu bashkangjitem muslimanëve në Medine. Një mëngjes mora rrugën për në Medine, por, si duket, idhujtarët më kishin përcjellë dhe më dolën në pritë.

Më munduan shumë. Disi arrita të ik! Me vrap e zura devën, dhe u drejtova kah Medina. Por idhujtarët nuk më lanë të qetë. Disa kalorës më kishin përcjellur tërë rrugës! Kur u afruan bërtita: "Ju e dini sa jam i shkathët me shtizë. Edhe një hap, dhe do ta gjeni vdekjen!"

Kalorësit më njihnin mirë, dhe e dinin se unë vërtetë do ta bëja një gjë të tillë, prandaj mbetën në vendin e tyre, si të shtangur. Njëri prej tyre hapi gojën: "Ti rob i mjerë! Ne të bëmë të pasur dhe ta rritëm famën. Nuk do të lëmë assesi të ikish me gjithë pasurinë me vete." Iu përgjigja: "Atë e kam fshehur në Mekke, e nëse doni, do t'ua tregoj edhe vendin, vetëm më lini të qetë."

Ata u pajtuan, e unë u tregova saktësisht vendin ku e kisha fshehur pasurinë. Ata u nisën për në Mekke, kurse unë vazhdova për në Medine.

Në Medine shkova drejt te Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai më pyeti se si kisha shpëtuar nga kurejshit, e unë ia tregova krejtësisht ngjarjen. Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem buzëqeshi, dhe tha: "Ka fituar Ebu Jahja në këtë tregti." (Këtë e përsëriti dy herë)

All-llahu i Madhëruar në Kur'an thotë: "**Ka nga njerëzit të cilët për hirë të All-llahut e flijojnë vetveten, e edhe All-llahu është shumë i mëshirshëm për robërit e vet.**" (Bekare: 207).

Prej asaj dite filloi jeta ime e re me Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem në Medine, së bashku me muhaxhirët

Klubi studentor

dhe ensarët. E forconim ummetin musliman, që ta kenë imanin e fortë dhe të jenë të sinqertë.

Jam luftëtarë i Bedrit, Uhudit dhe i Hendekut. Gjithnjë isha pranë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, siç ju thashë edhe më parë.

Pas vdekjes së Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, qëndrova besnik në kohën e hilafetit të Ebu Bekrit, Omerit dhe Othmanit radijall-llahu anhum.

Ndërrova jetë gjatë hilafetit të Aliut radijall-llahu anhu, gjegjësisht në vitin 36 hixhrij (v.658)

Më varrosën në Beki, vend në Medine Munevere.

A ende s'më njohët?

Unë jam Suhejb ibën Sinani. Asnjëherë nuk kam pretenduar hilafetin, ose ndonjë pozitë tjetër në administratën shtetërore. Nga principi, nuk kam transmetuar gojëdhëna nga Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Njerëzve u thosha: "Ejani t'ju flas për luftërat që kemi zhvilluar kundër armikut dhe për atë që kam mësuar prej Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem." Por asnjëherë nuk kam thënë: "Ka thënë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem..."

*Marrë nga libri: „A e di kush jam unë?” të autorit
Muhammed Hamza SA'DAVI,
botuar nga shtëpia botuese „Furkan ISM”*

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohej hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



A e di kush jam unë?



UNË KAM BLERË VETEN ME PASURINË TIME